



02 Nr.518

Dt.25.11.2016

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr.03/L-040 neni 13, dhe Statutit të Komunës së Shtimes, neni 53, Ligjit nr 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin nr 03/L-205, Vendimit të Kuvendit Komunal – Shtime Npi 01/140 datë 29.04.2016, Kryetari i Komunës mori këtë:

VENDIM - PRELIMINAR

- 1. Aprovohet** kërkesa e Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi për shpronësimin për interes publik i pronës së paluajtshme-pjesës së ngastrës me nr P-72809093-02671-0, Zona Kadastrale – Shtime, të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilët preken nga ndërtimi i rrugës Unaza e Jashtme e Qytetit të Shtimes me kompensimin e paluajtshërisë të pronarëve të pjesës të ngastrës sipas tabelave të bashkangjitura.
- 2. Obligohet** Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi – Sektori për çështje pronësore-juridike që brenda afatit prej 5 (pesë) ditëve të punës, pas nënshkrimit të këtij vendimi – preliminar, ta njoftoj të pronarët e pronave dhe zotëruesit të interesit e cila do të shpronësohet dhe brenda afatit prej 10 (dhjetë) ditëve të punës pas aprovimit të njëjtin ta shpallë në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, si dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.
- 3.** Kundër këtij vendimi apo cilëndo pjesë të tij kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike në gjykatën kompetente, subjekti kërkues dhe cilido person i cili është pronarë, apo zotërues i interesit në pronën e paluajtshme të prekur nga ky vendim.
- 4.** Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi – Sektori për çështje pronësore-juridike dhe Zyra Kryesore Financiare (ZKF).
- 5.** Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Iu dërgohet:

- Palës
- Zyrës Kryesore Financiare
- Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi
- Arhives



Tabela mbi shpronësimin në bazë të vendimit Preliminarë nr 02 nr 518 datë 25.11.2016

Komuna Shtime – Zona Kadastrale –Shtime							
Nr	Pronarë	Nr.i ngastrës	Kultura -klasa	Sipërfaqja e përgjithshme m ²	Sipërfaqja për shpronësim m ²	Sipërfaqja e mbetur m ²	Vërejtje
1	Ahmet (Mustafë) Ahmeti 1/6, nga Shtimja agim (Mustafë) Ahmeti 1/6, nga Shtimja Fetah (Bajram) Haxha 2/6, nga Shtimja Habib (Qazim) Haziri 2/6, nga Shtimja	P-72809093-02671-0	Lumë	11821	813	11008	